



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 83 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 17 / 07 / 2024

**VENDIM**

Nr. 18 date 17 / 07 / 2024

**PËR**

**PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT**

**“REHABILITIMIN E DIGES SE REZERVUARIT TE GADUROVES”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 17.07.2024 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e paraqitur nga Bashkia Mallakaster për Rehabilitimin e diges se rezervuarit të Gaduroves me lartësi H=36 m e ndertuar në vitin 1969.

Projekt zbatimi është përgatitur nga firma konsulente SELAS shpk. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se projekti është paraqitur sipas kërkesave të legjislacionit të mesiperm. Perfaqesuesit e firmes konsulente ishin prezent në mbledhje dhe dhënë sqarimet përkatëse në lidhje me masat e parashikuara për rehabilitimin e kësaj dige të cilat konsistojnë në rehabilitimin e disa elementeve kryesore të digës siç janë sistemi i shkarkimit, sistemi i marrjes së ujit, trupi i diges si dhe sistemet e monitorimit të digës. Duke qenë se kjo dige klasifikohet si dige me rrezik të lartë për shkak të numrit të njerezve në rrezik që ndodhen në zonën urbane poshtë saj, në diskutimet e organizuara gjatë takimit, antaret e KKDM e përqëndruan vëmendjen në plotësimin e kërkesave të Vendimit të KKDM Nr.05, datë 21.02.2024 sidomos në lidhje me llogaritjet për verifikimin e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të diges para dhe pas rehabilitimit të saj si dhe kontrollin e kapaciteteve të sistemit të shkarkimit të kërkuara në Vendimin e KKDM Nr. 36, datë 25.10.2023. Perfaqesuesit e Konsulentit konfirmuan se llogaritjet e qëndrueshmërisë së diges dhe kontrolli i kapacitetit të sistemit të shkarkimit janë realizuar në përputhje me kërkesat e KKDM të dhëna në Vendimet përkatëse të saj. Antaret e KKDM vënë në dukje faktin e mungesës së sistemit të alarmit në dige dhe në zonën poshtë saj, mungesën e matjeve të volumit aktual të ujit në rezervuar, problematiken e bllokimit të sistemit të marrjes së ujit dhe të sistemit të shkarkimit dhe pamundësinë e një investigimi të detajuar të gjendjes së pusëtës hyrëse për shkak të prezencës së ujit në rezervuar, kërkesën për zbrastje të rezervuarit gjatë punimeve të rehabilitimit të diges si dhe problematiken e mungesës së një rruge kalimi për banorët e fshatit Gadurove gjatë zbatimit të punimeve.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

**VENDOSI:**

- 1- Të miratojë projektin e zbatimit për rehabilitimin e diges se rezervuarit të Gaduroves të paraqitur nga Bashkia Mallakaster
- 2- Ti kërkojë bashkisë Mallakaster
  - a. Kontrollin e punimeve dhe caktimin e mbikqyresit të punimeve sipas kërkesave të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Mbi Miratimin e rregullores për sigurinë e digave”, neni 20 dhe 21;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- b. Të informoj me shkrim KKDM për procesin e zbrazjes së rezervuarit përpara fillimit të punimeve dhe kryerjen e matjeve topogjeodezike të kupës së rezervuarit deri në nivelin aktual të kreshtes së digës (272.0mmnd) dhe të nivelit normal (268.8 mmnd) të dhënë në Projekt;
- c. Të informoj me shkrim KKDM në lidhje me gjendjen e pusëtës hyrëse të sistemit të marrjes së ujit (Ujeleshuesi) dhe ndryshimet në projekt që mund të kërkojnë pas inspektimit të detajuar dhe konkret të zonës ku ndodhet pusëta hyrëse nga projektuesi sipas nenit 17 të VKM së mesiperme. Pas këtij kontrolli, projektuesi duhet të përgatit të gjitha detajet e nevojshme për pusëten dhe bazamentin e saj;
- d. Të marrë masat për hartimin e Planit të gadishmerisë në rastet e emergjencave civile në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe instalimin e një sistemi alarmi pas përfundimit të punimeve të rehabilitimit të digës. Ky plan duhet të marrë në konsideratë gjendjen e digës dhe të elementeve të saj pas punimeve të rehabilitimit dhe të dorëzohet për shqyrtim pranë KKDM sëbashku me dokumentacionin teknik të punimeve sipas faktit dhe aktit të kolaudimit të punimeve;
- e. Të kryej matjet e para të monitorimit të digës me instrumentat e monitorimit që do të instalohen në digë. Këto matje do të kryhen menjëherë pas përfundimit të punimeve dhe përfundimit të procesit të mbushjes së rezervuarit. Këto matje duhet të kryhen në mënyrë të vecantë në lidhje me filtrimet që mund të konstatohen në pjesën e poshtme të digës, nivelet dhe volumet e ujit në rezervuar, sipërfaqes dhe volumit të rezervuarit në nivele të ndryshme deri në nivelin maksimal të rezervuarit. Bazuar në këto matje, duhet të përgatitet një raport i monitorimit të digës i cili duhet të jetë pjesë e projektit të zbatimit sipas faktit që do të zbatohet në terren dhe dokumentacionit teknik të aktit të kolaudimit një kopje e të cilit do të dorëzohet në KKDM;
- f. Të hartohet plani dhe rregullorja e monitorimit të digës gjatë mbushjes së rezervuarit për herë të parë pas përfundimit të punimeve si dhe gjatë shfrytëzimit të digës për të paktën 10 vitet e para pas përfundimit të këtyre punimeve të rehabilitimit, sipas udhëzimeve të dhëna nga KKDM;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**